

FJALIM I KAROLINË ZIADEH
PËRFAQËSUESE SPECIALE E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM
DHE SHEFE E UNMIK-ut
DEBAT NË KËSHILLIN E SIGUTIMIT PËR UNMIK-un
Nju Jork
18 TETOR 2022

Z. President,

anëtarë të shquar të Këshillit,

Zoti President, më lejoni t'ju përgëzoj për presidencën tuaj të Këshillit të Sigurimit për muajin tetor. Në rajonin ku është pozicionuar UNMIK-u, ky muaj karakterizohet nga afate vendimtare në lidhje me Dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës - ky është në veçanti rasti i udhërrëfyesit për energjinë dhe targat me afate të fundit që po afrohen, si dhe diskutime të shumta në disa nivele evropiane në shumë çështjet që kanë të bëjnë me perspektivat evropiane të Serbisë dhe Kosovës, të cilat do të kenë ndikim jo vetëm në jetën e popullatës së këtij rajoni, por edhe në mjedisin politik dhe të sigurisë në të cilin Misioni vepron.

Kam nderin të informoj Këshillin e Sigurimit mbi Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për UNMIK-un dhe zhvillimet e fundit në Kosovë. Po ashtu do të ofroj vëzhgimet e mia për situatën në Kosovë, në një kontekst më të gjerë.

Siç është detajuar në raport, gjashtë muajt e fundit përfshinë shumë raste të qëndrimeve politike për çështje që mbeten pjesë e agjendës së dialogut të mbështetur nga BE-ja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Udhërrëfyesi i energjisë, liria e lëvizjes së njerëzve, vlefshmëria e dokumenteve të identitetit dhe asociacioni/bashkësia e komunave me shumicë serbe – për të përmendur

vetëm disa. Ne do të vazhdojmë të japim të gjithë mbështetjen e mundshme drejt suksesit të këtij dialogu. Po ashtu, jam e vetëdijshme se zhvillimet në Kosovë, si me të gjitha çështjet e hapura në rajon, ndikohen nga mjedisi i sigurisë evropiane në tërësi.

Në këtë këndvështrim, kam qenë në bisedime të ngushta me shumë partnerë dhe palë të interesuara në terren, si dhe me bashkëbisedues në mbarë rajonin. Një vlerësim i përbashkët është se çështjet që duken të qeta mund të kthehen lehtësisht në krye të agjendës së Dialogut. Kjo e rrit përgjegjësinë për sigurimin e koordinimit të ngushtë ndërmjet misionëve të ndryshme në terren. Kur punojmë së bashku, në mënyrë koherente dhe efektive, ne mund të kontribuojmë për të sqaruar keqkuptimet dhe për të shmangur përshkallëzimin. Ne gjithashtu mund të ndihmojmë për të fuqizuar liderët, vizioni i të cilëve i din përfitimet e uljes së tensioneve dhe jo të ndezjes së tyre. Liderë të cilët janë të gatshëm të lirojnë hapësirën për përparim dhe ndryshime pozitive.

Z. President,

Që nga pranvera e kaluar, të gjithë kemi vërejtur disa përshkallëzime në retorikën politike në mes të Prishtinës dhe Beogradit, si dhe disa momente tensioni akut në terren. Këto kërcënuan të pengojnë shumë nga përfitimet e arritura më parë përmes dialogut të mbështetur nga BE-ja. Në momente të tilla, vëmendja e të dyja palëve u përqëndrua në akuza të ndërsjella, në vend se të përdornin kanalet zyrtare dhe jozyrtare për t'u angazhuar në dialog konstruktiv.

Ndërhyrjet diplomatike, së bashku me një takim të nivelit të lartë për dialogun më 18 gusht, çuan në lehtësim të përkohshëm, duke zgjatur afatet dhe duke premtuar vazhdimin e diskutimeve. Megjithatë, gatishmëria e palëve për të rrezikuar konfrontime të rrezikshme në

terren, në rastin më të mirë, e ktheu procesin prapa. Në rastin më të keq, mund të çojë në pasoja shumë më serioze, edhe nëse janë të paqëllimta.

Z. President,

Në momentet kur kufiri ndërmjet provokimit politik dhe armiqësisë së hapur mjegullohet, na kujtohet rëndësia dhe roli i shquar i partnerit tonë të mandatuar ndërkombëtar, KFOR-it, prania e të cilit në vazhdimësi siguron një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur në Kosovë. Dëshiroj të shpreh falënderimin tim personal për Komandantin në largim të KFOR-it, Gjeneral Majorin Ferenc Kajari të Hungarisë, nën udhëheqjen e të cilit KFOR-i luajti rolin e tij në mënyrë shembullore. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj pasardhësin e tij të sapoardhur, Gjeneral Majorin Angelo Ristuccia, i cili padyshim do të vazhdojë të nxisë partneritetin thelbësor UNMIK-KFOR.

Z. President,

Siç e theksova këtu prillin e kaluar, Qeveria e Kosovës ka pasur një agjendë ambicioze, realizimi i së cilës varet nga vendimmarrja e drejtë, partneriteti i fortë dhe konsensusi publik. Ne mirëpresim përpjekjet e vazhdueshme të Qeverisë për forcimin e sundimit të ligjit dhe drejtësisë, të cilat mund të kenë sukses vetëm përmes pajtueshmërisë së plotë me të gjitha kornizat ligjore në fuqi dhe duke siguruar një proces të rregullt. Në këtë kontekst, do të theksoja rëndësinë e:

-Zbatimit të plotë të të gjitha vendimeve të gjykatave të larta, si ato të Gjykatës Kushtetuese,

- Respektimit të plotë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat sociale dhe ekonomike, pronën dhe lirinë e lëvizjes, për të gjitha komunitetet.
- Respektimit të plotë të të gjitha detyrimeve të ndërmarra dhe të ratifikuara më parë brenda kornizës së dialogut të përkrahur nga BE-ja.

Z. President,

Ka shumë zgjedhje që duhen bërë nga liderët politikë në ditët në vijim, për mënyrën se si të menaxhojnë ambiciet dhe objektivat e tyre duke pasur parasysh pasigurinë e madhe ekonomike dhe të sigurisë në këtë kohë. Zgjedhje midis bashkëpunimit ose ndarjes, midis kërcënimeve ose gjesteve të vullnetit të mirë, midis kompromiseve ose llogaritjeve me rezultat zero.

Për këtë përgjegjësi fillon nga shtëpia. Mes të gjitha sfidave, ne kemi qenë dëshmitarë të shembujve pozitivë të lidershit dhe bashkëpunimit. Qeveria e Kosovës mbetet e fokusuar në adresimin e çështjeve të rëndësishme në lidhje me sundimin e ligjit, përpjekje këto që presim të jenë vërejtur nga shtetet anëtare evropiane, të cilat janë duke i matur qëndrimet e tyre për regjimin e vizave dhe të udhëtimit për popullin e Kosovës.

Përderisa ne, bashkësia ndërkombëtare, mbetemi të angazhuar aktivisht në Kosovë, mbajmë edhe përgjegjësi. Ndër këto është mbështetja e atyre zgjedhjeve që ofrojnë shpresë për një të ardhme më të mirë për familjet dhe individët në të gjithë shoqërinë.

Z. President,

Nismat e bashkëpunimit në nivel të qeverive rajonale – pavarësisht nga etiketat, autorësinë dhe pjesëmarrjen, mund të kontribuojnë gjithashtu në zgjidhjen e tensioneve politike dhe problemeve. Kjo është veçanërisht e vërtetë tani, kur të gjitha pjesët e rajonit janë të prekura nga rreziqe të ngjashme të zinxhirit të furnizimit dhe sfida të tjera ekonomike.

Natyrisht, as nismat rajonale nuk janë ilaç. Paqja e qëndrueshme kërkon shumë më tepër, duke përfshirë angazhimin e drejtpërdrejtë të komuniteteve dhe kuptimin më të mirë të pikëpamjeve, shqetësimeve dhe interesave të tyre. Këtu roli i misioneve si ky i yni mund të bëjë më shumë për të mbështetur progresin.

Z. President,

Misioni ynë vazhdon të përshtasë përqendrimin e tij, duke çuar përpara disa nga iniciativat më të mira të nisura në të kaluarën, siç është agjenda e krijuar prej kohësh për ndërtimin e besimit, duke vlerësuar me saktësi realitetet aktuale. Ne po rishqyrtojmë prioritetet tona lidhur me burimet, po përsosim partneritetet tona institucionale dhe po përmirësojmë objektivat dhe kulturën tonë të brendshme të punës. Qëllimi im është që UNMIK-u të fokusohet në ato fusha ku prania jonë e vazhdueshme, në bashkëpunim me të gjithë familjen e OKB-së si dhe me partnerët tanë të tjerë në Kosovë, kontribuon vazhdimisht duke dhënë efekte pozitive.

Kjo përfshin:

1- Pjesëmarrjen dhe promovimin e komunikimit efektiv përtej vijave etnike dhe politike në të gjitha nivelet e shoqërisë. Kjo përfshin krijimin e mundësive që promovojnë një atmosferë ku respekti për të drejtat e njeriut, për sundimin e ligjit dhe për zgjidhjen paqësore të dallimeve manifestohet në mënyrë të vazhdueshme.

2- Shtimin e përkushtimit të Misionit për të mbështetur akterët e ndërtimit të besimit nga të gjitha pjesët e shoqërisë kosovare, duke përforcuar fuqinë dhe energjinë e atyre që kanë shtysën dhe orientimin për të formuar një të ardhme premtuese për veten dhe gjeneratat që pasojnë.

3- Ndhmën për të promovuar ndërgjegjësimin e gjerë për ndërvarësinë, problemet dhe interesat e përbashkëta të njerëzve në mbarë Kosovën dhe në mbarë rajonin. Dhe përfshin kryerjen e gjithë kësaj duke qenë të mirëinformuar për skenën aktuale politike rajonale dhe globale.

Z. President,

Misioni ynë do të avancojë punën e tij me partnerët lokalë për të çuar përpara agjendën e ndërtimit të besimit, me fokus te gratë dhe të rinjtë, por edhe më gjerësisht te udhëheqësit e ardhshëm dhe krijuesit e ndryshimeve nga të gjitha sferat e jetës. Gjatë gjashtë muajve të fundit, ne kemi përdor aftësinë tonë për të mbledhur njerëz në shumë mënyra. Kjo përfshin ofrimin e më shumë se 150 liderëve të rinj nga Kosova dhe rajoni në Asamblenë e katërt të Rinisë së OKB-së, forumi më i madh rinor multietnik në Kosovë, që organizuan Ditën e hapur globale për gratë, paqen dhe sigurinë, për të lartësuar profilin e pjesëmarrjes së grave në procese politike, dhe kemi mbështetur 37 OSHC nga të gjitha komunitetet e Kosovës për të lancuar raportin e tretë vjetor mbi të drejtat e njeriut. Në këto forume janë trajtuar tema të rëndësishme në mënyrë konstruktive dhe të sigurt: keqinformimi, gjuha e urrejtjes, gratë në lidhshmëri, vendimmarrja e të rinjve, dhuna në familje dhe të tjera. Ne po ashtu kemi mbështetur qasjen në drejtësi dhe të drejtat gjuhësore duke përfshirë iniciativat për ofrimin e ndihmës juridike, përkthyesve në gjykata dhe mjete falas për mësimin e gjuhës.

Z. President,

Pak javë më parë, në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme, Sekretari i Përgjithshëm deklaroi: “Ne jetojmë në një botë ku logjika e bashkëpunimit dhe dialogut është e vetmja rrugë përpara”, “Ne kemi nevojë për shpresë... dhe më shumë. Ne kemi nevojë për veprim”. Unë e kam përsëritur këtë mesazh gjatë takimeve të mia me liderë në mbarë rajonin për zhvillimet e fundit në Kosovë. Tani jam gjithnjë e më e bindur se çdo marrëveshje ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës mund të arrihet dhe zbatohet vetëm me një shkallë të lartë të përfshirjes dhe përgjegjësisë publike. Më lejoni këtu, të shfrytëzoj rastin të përgëzoj Përfaqësuesin Special të BE-së për angazhimin e tij të vazhdueshëm në këtë drejtim.

Bazuar në mandatin e dhënë nga ky Këshill për pranitë ndërkombëtare në Kosovë, ne presim bashkëpunimin me institucionet e Kosovës bazuar në mirëbesim dhe respekt të plotë për njëri-tjetrin.

Dëshiroj t'i shpreh mirënjohjen time të thellë këtij Këshilli, për angazhimin e qëndrueshëm dhe mbështetjen e vazhdueshme dhënë Misionit tonë.

Faleminderit z. President.